



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.1324/2 Prot.

Tiranë, më 06/ 10 / 2021

V E N D I M

Nr. 187 , datë 06 / 10 / 2021

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “a”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën Nr. 169 Regj, datë 21.09.2021, paraqitur nga ankuesi R.B, kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorisë Vendore të Policisë, Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, me pretendimin për diskriminim për shkak të moshës dhe gjendjes familjare. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, ankuesi R.B ka parashtruar se, ka qenë punonjës policie me gradën “Inspektor” dhe është përjashtuar me urdhrin nr. 1146, datë 09.10.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit me motivacionin “*Ndaj tij merret masë disiplinore e përjashtimit nga policia*”, urdhër i cili është shfuqizuar me vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë nr. 3896, datë 01.11.2018.

Ankuesi shpjegon se, me vendimin nr. 3896, datë 01.11.2018, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, ka vendosur, shfuqizimin e vendimit nr. 352, datë 23.09.2015, të Drejtorit të Policisë së Shtetit “Për përjashtim nga policia” dhe vendimit të Komisionit të Apelit nr. 213, datë 08.10.2015. Ankuesi thekson se, urdhri i Drejtorit të Policisë së Shtetit nr. 1146/5, datë 09.10.2015, ka dalë më pas, ndërkohë që po zhvillohej procesi gjyqësor që ka konstatuar pavlefshmërinë e vendimeve nr. 352 dhe nr. 213. Pra, si konkluzion, urdhri nr.1146/5, datë 09.10.2015 është nul, sepse është nxjerrë në bazë dhe për zbatim të dy vendimeve nr. 352 e 213, tashmë këto dy vendime të anuluar, të konstatuara të pavlefshme me vendim gjykate.

¹Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

Ankuesi shprehet se, juridikisht përjashtimi i tij me urdhrin nr. 1146/5, datë 09.10.2015, është në shkelje të ligjit.

Në mbështetje të këtij detyrimi ligjor, vendimit gjyqësor të formës së prerë, ankuesi deklaroi se vazhdimisht ka kërkuar sipas ligjit rikthimin e tij në polici, brenda nevojave për vendet vakante që Policia e Shtetit ka patur. Sipas ankuesit, vende vakante ka patur dhe ka, dhe se janë rimarë punonjës të tjerë të përjashtuar. Vendimi i gjykatës i formës së prerë e lejon rikthimin në detyrë, por sipas vendimit “nëse dëshiron punëdhënësi”, pra duhet “vullneti i tij”, edhe në rastin kur ai vetë shkel ligjin dhe jo nga ndonjë pengesë ligjore (si p.sh. mungesë vendesh vakante). Ankuesi pretendon se, mosdashja pa shkak ligjor dhe keqinterpretimi i rastit në fjalë, praktikisht për shkak të “gjendjes familjare” apo “moshës”, apo për arsye të tjera që nuk i janë deklaruar ndonjëherë, përbëjnë veprime diskriminuese në dëm të interesave të tij dhe bien ndesh me ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjet në fuqi, me Kartën Sociale Evropiane të të Drejtave të Punonjësve të Policisë.

Duke marrë shkas nga përgjigja nr. R-42/1 datë 13.08.2021, e Drejtorit të Policisë Vendore Tiranë, ankuesi ka paraqitur ankesën, duke mos qenë dakort me përmbajtjen e përgjigjes. Ankuesi pretendon se kjo përgjigje është e pabazuar dhe bie ndesh me kërkesat e dispozitave ligjore:

- ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, nenit 49;
- ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”;
- ligjit nr. 252/2013 “Për nëpunësin civil”, i cili përfshin në sferën e rregullimit të tij edhe punonjësit e Policisë së Shtetit;
- është në shkelje të vendimeve unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që kanë fuqinë e ligjit, siç janë: vendimi nr. 31, datë 14.04.2003; vendimi nr. 7, datë 01.06.2011 dhe vendimi nr. 4, datë 01.07.2020;
- është në kundërshtim edhe me orientimet e drejta ligjore të Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- Është në interpretim të gabuar të ligjit nr. 10142, sepse është institucioni që nuk ka plotësuar dokumentat për të përfituar nga statusi i ushtarakut, sipas ligjit nr. 10142, pasi ankuesi është subjekt i këtij ligji.

Në lidhje me përgjigjen nr. R-42/1 datë 13.08.2021, të Drejtorit të Policisë Vendore Tiranë, ankuesi parashtron kundërshtimet e mëposhtme:

Së pari: sipas pikës 1, të përgjigjes, që ai të përfitojë nga ligji nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar, duhet që të jetë në punë dhe pastaj ti nënshtrohet këtij vlerësimi.

Së dyti: sipas pikës 2, të përgjigjes, ankuesi deklaron se ka mbi 14 vjet e 6 muaj shërbim në radhët e Policisë së Shtetit dhe dosja e tij personale ndodhet në këtë institucion nga ku mund të verifikohen kriteret ligjore dhe profesionale të pozicionit të punës ku ka shërbyer.

Së treti: sipas pikës 3, të përgjigjes, ankuesi thekson se, nuk është përfitues i ligjit nr. 10142, pra nuk trajtohet me pension të parakohshëm suplementar ose pension shërbimi. Në kushtet që ndodhet, referuar kësaj pike të përgjigjes, ankuesi shprehet se i takon që të rikthehet në polici.

Ankuesi shprehet se, ekziston mundësia ligjore dhe praktike që ai të bëhet pjesë e strukturave të Policisë së Shtetit, nëpërmjet konkurimit, sepse në vazhdimësi ka bërë kërkesa brenda afateve ligjore “dy vjet”, por edhe përtej këtij afati, që nga momenti i largimit, sepse një e drejtë e tillë parashikohet nga dispozitat e ligjit nr. 108/2014, i ndryshuar me ligjin nr. 58, të vitit 2017.

Sipas ankuesit ndërprerja e marrëdhënies financiare, ndalimi i pagës para dhënies së vendimit të formës së prerë, kur kundërshtohen dy vendimet që ishin objekt shqyrtimi në gjykatë, janë veprime arbitrare, diskriminuese, shkelje e të drejtave të njeriut dhe veprime të paligjshme. Në bazë të nenit 46, të ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe nenit 180 dhe 182 të Rregullores së Policisë së Shtetit, miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09.2015, nuk ka asnjë parashikim për ndërprerjen e marrëdhënies financiare me daljen në lirim me urdhrin e lirimit, kur ankimohen në gjykatë vendimi i drejtorit dhe vendimi i Komisionit të Apelit Disiplinor, për masën e përjashtimit të punonjësve të policisë. Si raste të ndërprerjes së marrëdhënies të punës në Policinë e Shtetit sipas ligjit nr.108/2014, i ndryshuar, njihet vetëm rasti i lirimit nga policia, sipas nenit 46/2.

Kur bie përjashtimi (pra vendimi nr. 352 dhe 213, që u konstatuan të pavlefshme me vendim gjyqësor të formës së prerë) me vendim gjykate, ankuesi ngre pyetjen se, si ka mundësi që të mbetet në fuqi lirimi, përjashtimi, kur motivi është pa shkaqe të arsyeshme, pa shkaqe të ligjshme, sikundër ka vendosur gjykata. Sipas ankuesit, rasti i tij është shprehje konkrete e shkeljes së ligjit, e të drejtave themelore të njeriut dhe e shfaqjes së fenomenit të diskriminimit, sipas nenit 3, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Ankuesi shprehet se, në mënyrë të padrejtë nuk është trajtuar as me pagën kalimtare sipas statusit të ushtarakut me ligjin nr. 10142, duke e konsideruar këtë fakt diskriminim maksimal, që po i bëhet nga sheti shqiptar, nëpërmjet veprimeve të kryera deri tani.

Ankuesi sqaron se, për herë të parë për urdhrin e përjashtimit nga radhët e Policisë së Shtetit me nr. 1146/5, datë 09.10.2015, ka ardhur në dijeni në datë 14.10.2020 me shkresën e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë me nr. R-43/1, datë 14.10.2020. Nëse ky urdhër është vendimi i vetëm dhe përfundimtar ndaj ankuesit për largimin nga puna, ku bazohet ky urdhër, apo dublon vendimet nr. 325 dhe nr. 213.

Ankuesi pretendon se neni 49 i ligjit “Për Policinë e Shtetit” të ndryshuar interpretohet gabim.

Përmendet tek vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë me nr. 31, datë 14.04.2003, por më pas ky Kolegj ka interpretuar si në rastet analoge edhe tek vendimi nr. 7, datë 01.06.2011 dhe në mënyrë të zgjeruar ka nxjerrë vendimin unifikues nr. 4, datë 01.07.2020: duke iu referuar ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe që duhet të zbatohet edhe për punonjësit e policisë dhe garantimin e rikthimit në detyrë, në rastin e largimit nga puna. Më tej, ky Vendim Unifikues i Kolegjeve të Gjykatës së Lartë vazhdon: “...Fakti që ligji “Për Policinë e Shtetit”, nuk ka rregulluar në mënyrë specifike çështjen e zgjidhjes të pasojave të largimit të kundraligjshëm me ligj, të punonjësit të policisë të shtetit, nuk do të thotë se ky ligj e ka përjashtuar rikthimin në detyrën e mëparshme të punonjësit të policisë.” Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, ndër të tjera vlerëson dhe thekson: “...se marrëdhëniet e punës të punonjësve të policisë së shtetit, janë marrëdhënie pune me natyrë administrative, pasi jo vetëm rregullimi i tyre bëhet nga një ligj i të drejtës publike, por edhe natyra e lindjes së këtyre marrëdhënieve nuk realizohet në bazë të kontratës së punës, por përmes një akti unilateral të titullarit kompetent...”

Ankuesi thekson se, legjislacioni që rregullon marrëdhëniet e punës në Policinë e Shtetit, ka pësuar disa herë ndryshime. Së fundmi ka dalë ligji nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar me ligjin nr. 58/2017.

Fakti që pasojat e largimit të kundraligjshëm nga detyra të një punonjësi policie nuk ishin rregulluar ndonjëherë në mënyrë shteruese, i kanë dhënë mundësinë ligjvënësit që të bëjë ndryshime herë pas here, nëpërmjet miratimit të ligjit nr. 252, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i cili përfshin në sferën e rregullimit të tij edhe punonjësit e policisë së shtetit. Sipas këtij rregullimi ligjor, statusi dhe të gjitha garancitë që parashikohen për nëpunësit civilë, janë të zbatueshme edhe për punonjësin e policisë së shtetit, për aq sa ligji i posaçëm që trajton marrëdhëniet e punësimit në këtë fushë nuk parashikon ndryshe. Edhe në këtë pikë, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, thekson tek vendimi unifikues nr. 1, datë 11.01.2021, ndër të tjera: “ Pikërisht një mbrojtje më e fortë ligjore për punonjësit e policisë që sugjerohet edhe në vendimin unifikues nr. 31, datë 14.04.2003 dhe nr. 4 datë 01.07.2020 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, u realizua me ligjin nr. 152/2013, nëpërmjet të cilit garantohet rikthimi në detyrë i tyre, në rastin e largimit të padrejtë, për shkak të një urdhri që nxjerr organi epror.”

Sipas ankuesit, neni 49, i Ligjit “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, lidhur me “rikthimin në polici”, i referohet disa kërkesave tek neni 46, i ligjit nr. 108/2014, i përditësuar, duke e kufizuar të drejtën për t’u rikthyer në detyrë “brenda 2 viteve”, vetëm atëherë kur punonjësi është liruar me motivacionin e shkurtimit të organikës si dhe ata që përfitojnë pagë kalimtare dhe pension suplementar. Ankuesi pretendon se, nuk përfshihet në këto dy raste ndaluese që përmenden tek neni 49, i ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.

Ankuesi pretendon se, nuk ka asnjë pengesë ligjore që ai të rikthehet në punë dhe aty ku ligji nuk e ndalon do të thotë që lejohet. Ankuesi pretendon se nuk është mbajtur qendrim i njëjtë për raste të ndryshme. Ankuesi pretendon se në disa raste analoge, disa punonjës policie janë

përrjashtuar nga radhët e policisë së shtetit dhe në situatë të njëjtë me të janë rimarë përsëri në radhët e policisë së shtetit dhe konkretisht: ish-polici R.F, Komisariati i Policisë nr. 2, Tiranë, është rikthyer në detyrë, rikthim pas vitit 2018; ish-polici F.D, Komisariati i Policisë nr.1, Tiranë, është rikthyer në detyrë, rikthimi pas vitit 2018; ish-polici E.H, Komisariati i Policisë nr. 1, Tiranë, është rikthyer në detyrë, rikthim pas vitit 2018; ish-polici B.B, Komisariati i Policisë nr.1, Tiranë, është rikthyer në detyrë, rikthimi mbas vitit 2018. Ankuesi pretendon se edhe ai ka paraqitur kërkesë për rikthim në detyrë, kërkesa të paraqitura brenda afateve ligjore, qysh nga viti 2017-2018 e deri më sot, pra brenda afateve “dy vjet” siç kërkohet nga ligji, por nuk ka marrë përgjigje pozitive.

Ankuesi shprehet se, ndonëse gjatë gjykimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ai ka kërkuar edhe rikthimin në punë, e ka ditur se ligji aktual nuk parashikonte në mënyrë specifike, që të shprehej gjykata për rikthim në punë, prandaj edhe gjykata është shprehur me fjalët “rrëzim për kërkimet e tjera”. Sipas ankuesit, për sa kohë kanë rënë vendimet nr. 352, datë 23.09.2015 dhe nr. 213, datë 08.10.2015, detyrimisht arrihet në përfundimin se ka rënë edhe urdhri që është nxjerrë më mbrapa këtyre dy vendimeve, pra ka rënë urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm “Për përjashtimin e tij nga policia”

Ankuesi shprehet se, *de facto* ka shpërdorim të detyrës nga punonjës të caktuar, ku qëllimisht pengohet rikthimi i tij në detyrë dhe se do të jetë i detyruar që ti drejtohet për kompetencë hetimi edhe Prokurorisë Speciale (SPAK-ut), për të hetuar dhe për ti vënë përpara përgjegjësisë penale personat që qëllimisht zvarrisin dhe pengojnë rikthimin e tij në detyrën e punonjësit të policisë së shtetit.

Përfundimisht ankuesi kërkon nga Komisioneri marrjen e masave për kthimin e tij në punë sipas ligjit dhe vendimit të gjykatës dhe praktikave të personave të tjerë që janë marrë në punë në të njëjtat kushte me ato të ankuesit.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Bazuar në aktet e administruara, rezulton se, ankuesi ka qenë ish punonjës i Policisë së Shtetit. Gjatë ushtrimit të detyrës si punonjës i Policisë së Shtetit, ndaj ankuesit me vendimin nr. 352, datë 23.09.2019, i Drejtorit të Policisë së Shtetit dhe është dhënë masa disiplinore “Përjashtim nga policia”, vendim i cili është lënë në fuqi nga Komisioni i Apelimit pranë Drejtorisë së Policisë së Shtetit nr. 213, datë 08.10.2015. Pas lënies në fuqi të masës disiplinore nga ana e Komisionit të Apelimit, ka dalë urdhri nr. 1146/5, datë 09.10.2015, i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për përjashtimin nga Policia e Shtetit të një punonjësi policie” me motivacionin “*Ndaj tij merret masë disiplinore e përjashtimit nga policia*”.

Ankuesi ka kundërshtuar gjyqësisht vendimin nr. 352, datë 23.09.2019, të Drejtorit të Policisë së Shtetit dhe vendimin nr. 213, datë 08.10.2015, të Komisionit të Apelimit pranë Drejtorisë së Policisë së Shtetit, duke kërkuar ndër të tjera përveç dëmshpërblimeve përkatëse edhe rikthimin e marrëdhënieve të punës. Me vendimin nr. 3896, datë 01.11.2018, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë ka vendosur: “*Ndryshimin e vendimit nr. 1846 (80-2016-*

1820), datë 18.04.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Pranimin e pjesshëm të padisë. Shfuqizimin e vendimit nr. 352, datë 23.09.2015, të Drejtorit të Policisë së Shtetit për dhënie mase disiplinore “Përrjashtim nga Policia” ndaj paditësit R.B. Shfuqizimin e vendimit nr. 13, datë 08.10.2015 të Komisionit të Apelit pranë Drejtorisë së Policisë së Shtetit. Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Policisë së Shtetit që t’i paguajë paditësit R.B një dëmshpërblim në masën e 5 (pesë) muajve pagë. Rrëzimin e padisë në lidhje me kërkimet e tjera.” Nga aktet e administruara nuk rezultojnë që kundër vendimit nr. 3896, datë 01.11.2018, të Gjykatës Administrative e Apelit Tiranë, të jetë ushtruar ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

Rezultojnë se, ankuesi ka bërë një numër të konsiderueshëm kërkesash drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, Ministrisë së Brendshme, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, pranë Ministrisë së Brendshme, për rikthimin e tij në detyrë, meqënëse me vendimin nr. 3896, datë 01.11.2018, të Gjykatës Administrative e Apelit Tiranë, ishte konstatuar se largimi i tij nga puna kishte qenë i padrejtë.

Ankesën lidhur me refuzimin për rikthimin e tij në detyrë si punonjës policie, pas vendimit të gjykatës, ankuesi e ka paraqitur edhe pranë Avokatit të Popullit. Ky i fundit i ka kthyer përgjigje ankuesit me shkresën nr. K2/R14-2 prot., datë 12.11.2019, se nuk mund të ndërhyjë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për rikthimin e tij në punë në strukturat e Policisë së Shtetit, pasi gjykata kishte rrëzuar kërkesën e tij për rikthimin në punë. Rezultojnë se, gjatë muajve gusht dhe korrik 2021 ankuesi i është drejtuar përsëri Avokatit të Popullit, në lidhje me këtë problematikë. Me shkresën nr. K2/R6-3 prot., datë 20.09.2021, Avokati i Popullit, përsëri i ka kthyer përgjigje ankuesit se nuk mund të ndërhyjë për të rekomanduar rikthimin e tij në strukturat e policisë së shtetit dhe se ankesa e tij është trajtuar nga ky institucion edhe më parë.

Në lidhje me refuzimin për të zgjidhur pozitivisht kërkesat e tij drejtuar Policisë së Shtetit, sa i përket rikthimin në këtë strukturë, ankuesi i është drejtuar edhe më parë Komisionerit. Kështu rezultojnë se, ankuesi ka paraqitur ankesën nr. 92 Regj, datë 14.08.2020, kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me pretendimin për diskriminim për shkak të moshës dhe gjendjes familjare. Me vendimin nr.152, datë 30.10.2020, Komisioneri ka vendosur: “Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 92 Regj., datë 14.08.2020, të paraqitur nga ankuesi R.B kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.”, për shkak se e njëjta mosmarrëveshje dhe me të njëjtat palë, ishte bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor nga ana e ankuesit. Ky vendim nuk rezultojnë të jetë kundërshtuar në gjykatë.

Në lidhje me problematikën e refuzimit për t’u rikthyer në strukturat e policisë së shtetit, pasi gjykata ka konstatuar se largimi i tij kishte qenë i padrejtë, ankuesi ka paraqitur disa ankesa gjatë muajve korrik-gusht-shtator 2021, drejtuar disa institucioneve si: Ministrisë së

Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, si dhe Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave, për të cilat ka marrë përgjigje negative për kërkesën e tij për t'u rithyer në strukturat e policisë së shtetit.

Sikurse deklaroi në ankesën objekt shqyrtimi, ankuesi i është drejtuar Komisionerit duke marrë shkas nga përgjigja që i është kthyer nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë me nr. R-42/1, datë 13.08.2021, me përmbajtjen e të cilës nuk është dakort. Pra, sipas shpjegimeve të ankuesit, ky i fundit i është drejtuar Komisionerit me ankesën objekt shqyrtimi duke kundërshtuar përmbajtjen e kësaj shkrese, për arsyet e bëra prezent në ankesë.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, germa "a", të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", i ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës dhe bazuar në nenin 33, pika 4, germa "c" të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar, ku parashikohet se: "4. Ankesa nuk pranohet nëse: a) shfuqizuar; b) përbën abuzim me të drejtën e ankimit para komisionerit, ose është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji; c) e njëjta çështje është duke u shqyrtuar në kuadër të një anese tjetër ose për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja; ç) është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim; d) të gjitha faktet që përbëjnë thelbin e ankesës kanë ndodhur para hyrjes në fuqi të këtij ligji; dh) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja e dëgjimit për sjelljen diskriminuese", Komisioneri vlerëson se ankesa nuk duhet të pranohet, bazuar në arsyetimin vijues:

Së pari: Me vendimin nr.152, datë 30.10.2020, Komisioneri ka disponuar më parë në lidhje me të njëjtat pretendime të ankuesit, duke vendosur të ndërpresë procedurën administrative të shqyrtimit të ankesës me nr. 92 Regj, datë 14.08.2020, të depozituar nga ankuesi kundër DPPSH, për shkak se e njëjta mosmarrëveshje dhe me të njëjtat palë, ishte bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor nga ana e ankuesit. Vendimi nr. 152, datë 30.10.2020 i Komisionerit, nuk rezultoi të jetë kundërshtuar në gjykatë.

Komisioneri vlerëson se, për të njëjtën çështje të bërë objekt shqyrtimi nga ankuesi nëpërmjet paraqitjes së kësaj anese, Komisioneri e ka marrë një vendim të mëparshëm. Komisioneri vlerëson se, nuk nuk jemi në kushtet kur kemi të dhëna të reja, në mënyrë që të mundësohet marrja në shqyrtim e pretendimeve të bëra nga ankuesi në ankesën objekt shqyrtimi. Fakti që ankuesi ka depozituar ankesën duke marrë shkas nga përgjigja e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë, me nr. R-42/1, datë 13.08.2021, nuk mund të konsiderohet si një e dhënë e re. Përgjigja që i është kthyer ankuesit nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, në përgjigje të kërkesës së depozituar prej tij, hyn në kuadrin e kërkesave të vazhdueshme që ankuesi ka paraqitur, jo vetëm pranë këtij subjekti, lidhur me problematikën e refuzimit të kërkesave të tij

për t'u rikthyer në strukturat e policisë së shtetit, pas vendimit gjyqësor. Çështja e parashtruar për zgjidhje dhe që përbën objektin e kësaj ankese është e njëjtë me çështjen e marrë më parë në shqyrtim nga ana e Komisionerit dhe për të cilën është marrë një vendim, i cili nuk është kundërshtuar në gjykatë nga ana e ankuesit.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se për ligjen kërkesat e nenit 33/4/c, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe ankesa e paraqitur nuk mund të pranohet pasi për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33, pika 4, gërma “c”, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa e paraqitur nga ankuesi R.B kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorisë Vendore të Policisë, Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, nuk mund të pranohet pasi për të është marrë një vendim i mëparshëm dhe nuk ka të dhëna të reja, dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 32/1/a , nenin 33, pika 4, gërma “c” të Ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës Nr. 169 regj., datë 21.09.2021, të paraqitur nga ankuesi R.B kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Drejtorisë Vendore të Policisë, Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Mosha dhe gjendja familjare
Fusha: Punësim
Lloji i vendimit: Mospranim